

**LEDIA DUSHKU**

**NGA “ARMIKE” NË “MIKE DHE BURIM QYTETËRIMI”:  
DUALIZMI NË PERCEPTIMIN E SHQIPTARËVE  
TË KORÇËS PËR FRANCËN  
(1913-1920)**

*“Franca, burim’i liriës, nana e idealeve të nalta, atdheu i burrave të theroresuëm për të nxjerrë njerin nga balta e robëniës, kjo Francë, në punën e Shqipëriës i haroj krejt, i shkeli ndër kambe gojdhonet e tradicionet e saj”.*

*Përlindja e Shqipëniës, 17/30 gusht 1913<sup>1</sup>*

*“Të duam këtë të nderçmë Komb Francez i cili na mbush me kaq mirëbesim, të lutemi për Atë dhe Aliatët për fitore të plotë, për triumfin e së drejtave të njerëzies edhe të drejtësisë së përgjithshme, edhe të thëreshim “Rroft e nalta Nënë e lirive botës, roftë mbrojtësja e madhe e popujve të shtenguar, roftë Franca e pavdekurë, rofshin Aliatët e mëdhenj”.*

*Gazet’ e Korçës, 6/19 Korik 1917<sup>2</sup>*

**Dualizmi në perceptimin e shqiptarëve për Francën  
në prag të Luftës së Parë Botërore**

Skicimi i perceptimit të shqiptarëve për Francën nga momenti i Shpalljes së Pavarësisë deri në prag të Luftës së Parë Botërore është realizuar duke u mbështetur në ligjërimin e intelektualëve i pasqyruar në publicistikën e viteve 1913-1914. Kjo për arsyen e thjeshtë, sepse një kategori e tillë shoqërore luan jo vetëm rolin e informuesit por, më tej edhe atë të emancipuesit të shoqërisë e të kombit<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> “Na dhe Fuqiët e mëdha”, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit’ i I, N. 6, Vlorë, 17/30 gusht 1913, f. 2.

<sup>2</sup> “Fjalë panegjirike. E thënë prej z. P. Harisadhit, sekretar gjeneral i Këshillës Qeveritare të Republikës Shqipëtare, në Kishën e Shën Gjergjit pas lutjes së kremtimit të 14 Korikut”, në *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i I, Numër 71, Korçë, 6/19 Korik 1917, f. 1-2.

<sup>3</sup> Për më shumë në lidhje me rolin e intelektualit në emancipimin e shoqërisë dhe të kombit përmes fjalës shih: Enis Sulstarova, *Jam Evropë! Intelektualët dhe ideja e Evropës në vitet 1918-1939 dhe 1989-2006*, Shkup: Logos-A, 2012, f. 42-47.

Pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, kumti ligjërues i intelektualëve e ravijëzoi perceptimin për Francën me tone realiste, përmes një marrëdhënieje dyfishë që merrte shkas nga qëndrimi i diplomacisë franceze karshi shqiptarëve e çështjes së tyre kombëtare dhe, modeli qytetërues që shteti francez mbartte dhe përçonte. Ky lloj ambiguiteti bëri që cilësimet negative për Francën, si “*armike*” e krijimit të Shqipërisë, “*mbështetëse e copëtimit*”, “*mike e armiqve tanë serbë dhe grekë*”, të sfidoheshin në të njëjtën kohë nga cilësimet pozitive për të, si “*vendi i Lirisë, i Barazisë, i Vëllazërisë*”, “*burim i qytetërimit*”.

Në shkrimin “Na dhe Fuqiet e Mëdha”, editori i gazetës *Përlindja e Shqipëniës*, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, shprehej me një frymë kritike ndaj diplomacisë franceze, për planet e zhbërjes së Shqipërisë në kuadrin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913), përkundër parimeve që Franca vetë kishte shpallur se mbronte.

*“Franca, burim’i liriës, nana e idealeve të nalta, atdheu i burrave të theroresuëm për të nxjerrë njerin nga balta e robëniës, kjo Francë, në punën e Shqipëriës i haroj krejt, i shkeli ndër kambe gojzhanet e tradicionet e saj. Franca e sotme, vijonte ai, desh t’a therorosojë pa mëshirë lirin e kombit t’onë për ca interesa fort pak të lavdishme, interesa të cilat Frangu i vërtetë, kurr s’i ka vënë më një shkallë me ideat e nalta të liriës e të drejtësisë”<sup>4</sup>.*

Në vijim të artikullimit, francezët stigmatizoheshin me epitetet “*të lig*”, “*të pashpirt*”, ata konsideroheshin mbështetës, madje inkurajues “*me tanë fuqiën e tyne të kërkimeve të Grekëve e të Sllavëve*”, mëtime të cilat kishin në themel “*veç fuqinë dhe padrejtësinë*”<sup>5</sup>. Kjo natyrë ekstreme ligjërimi, i vendoste francezët jo vetëm në të njëjtin nivel negativ perceptimi me rusët, por shpesh herë bëhej fjalë edhe për këmbim rolesh mes Francës dhe Ruisë, e cila pas caktimit të kufijve veriorë të shtetit shqiptar, dalëngadalë filloi të tërhiqej mënjana<sup>6</sup>. Në shkrimin e

<sup>4</sup> “Na dhe Fuqiet e mëdha ...”, f. 2.

<sup>5</sup> Po aty, f. 1.

<sup>6</sup> Franca ishte Fuqia e Madhe pjesë e Antantës, e cila pas caktimit të kufijve veriorë dhe verilindorë të shtetit shqiptar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, u bë shumë aktive dhe zëvendësoi Ruisinë për të kundërshtuar qëndrimet e Fuqive të Aleancës Tripalëshe. Ajo luajti rolin e violinës së parë brenda Antantës në përcaktimin e kufirit jugor të shtetit shqiptar, rol ky që kushtëzohej nga disa arsye. Së pari, përcaktimi i kufirit jugor ishte larg interesave të Ruisë, e cila nuk mund të pretendonte rolin parësor që kishte luajtur jo pa sukses në mbrojtjen e kauzës

botuar në *Përlindja e Shqipëniës*, më 3 gusht 1913, Franca konsiderohej si “*e vetmja Fuqië e trimarrveshjes më kundërshtare në heshtjet t’kufiëvet*”<sup>7</sup>. Veprimtaria e diplomacisë franceze në lidhje me çështjen shqiptare perceptohej kështu jo vetëm si një veprimtari në funksion të asaj ruse, por edhe si shprehje e synimeve të caktuara, të cilat Franca do t’i ndiqte deri në mbarim të Konferencës së Ambasadorëve. “*Pse të mos pretendonin fqinjët e tanë*” ngrihej pyetja në *Përlindja e Shqipëniës*, kur krahas ndihmës së Rusisë, kishin edhe mbështetjen e Francës

“*nanës së liriës, vëllazëriës e parasiës, burim i qytetërimit*”<sup>8</sup>, e cila “*u gëzonte për të ndarit e Shqipëtarëve në mes të fitonjësve*”<sup>9</sup>.

sllave në Ballkan. Së dyti, me statusin e fuqisë mesdhetare, Franca synonte kontrollin e rrugëkalimeve detare e të vendeve strategjike rreth saj. Me një flotë të vendosur në Korfuz, ishull që për një kohë të gjatë kishte qenë nën administrimin e saj, ajo u tregua aktive dhe e zellshme për të mbështetur pretendimet greke për kufijtë e Shqipërisë. Këtë qëndrim politika franceze e mbajti edhe kur u përcaktua në terren vija tokësore kufitare shqiptaro-greke.

Politika franceze mbajti qëndrim jo mbështetës edhe në çështjet e organizimit të shtetit shqiptar. Në projektin e paraqitur më 20 maj 1913 në Konferencën e Londrës, ajo bëri të pavlefshëm projektin që dy Fuqitë e Adriatikut, Austro-Hungaria dhe Italia kishin hartuar. Ndonëse pranonte idenë e pavarësisë së Shqipërisë, projekti francez e shihte realizimin e saj si një proces afatgjatë që do të zbatohej përmes kalimit në etapa ndërmjetëse. Duke mos pasur besim në aftësitë shtetformuese të shqiptarëve, funksionet qeverisëse nuk do t’i kryente qeveria shqiptare, por një komision ndërkombëtar. Ky i fundit do të realizonte edhe studimin e rrethanave për të bërë të mundur kalimin e shtetit shqiptar nga një etapë në tjetrën.

Për një trajtim të plotë në lidhje me qëndrimin e Francës karshi çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe kur u përcaktua në terren kufiri shqiptaro-grek shih: Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: Toena, 2012, f. 133-166, 247-255, 258-264; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik)*, Vëllimi II (1912-1918), Tiranë: 8 Nëntori, 1987, f. 261-265. Projekti francez për organizimin e Shqipërisë, Londër, 16 maj 1913; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Vëllimi I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013, f. 111, 128; Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)*, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, f. 204-218.

<sup>7</sup> Beri, “Kufiët e Shqipëriës. Shqipëria e lirë.”, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit’i I, N. 2, Vlorë, 3/16 Gusht, 1913, f. 2.

<sup>8</sup> “Na dhe Sërbët”!, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit’i I, Vlorë, N. 14, 14/27 Vjesht` e I 1913, f. 1-2.

Por në dallim nga Rusia, për të cilën sjellja karshi shqiptarëve ishte e pritshme, në rastin e Francës, në faqet e *Përlindja e Shqipëniës*, manifestoheshin tone zhgënjimi, që artikuloreshin në shprehje të tilla si:

*“Kësaj i thankan drejtësië Francasit e sotëm....”*<sup>10</sup>, apo *“kjo punë provoi sa pare bajnë në Francë idhcat për liriën e të drejtën e kombeve”*<sup>11</sup>.

Edhe Jani Vruho, veprimtar i dalluar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, i gjykonte po ashtu ashpër iniciativat e diplomacisë franceze në çështjen e Shqipërisë. Në ligjërimin e tij, Franca vihej në “shoqëri të ngushtë” me Rusinë, vendin e autokracisë, ndërkohë që dhimbja për shqiptarët dhe zhgënjimi për politikën franceze mbartte ngjyra të forta.

*“... Nuk na vjen aq rëndë nga të sjellat e Ruisë, se nga një shtet, i cili... pa u trembur nga shekulli i qytetërimit në të cilin rron, mundon kaqë milionë të popullit të tij duke i kalbur ndenë derbaç e duke u marrë shpirtin ndënë bodrumet (nuk mund të pritët tjetër gjë). Por kur shohim një shtet si të Francës të bëhet jo vetëm vegël po edhe skutinë për të pastruar poshtërsirat e politikës pansllavike, - kjo na bën të lëmë mëntë me popullin francez e më tepër me shtypin e tyre, i cili u gri së thirruri e së çjerruri për të copëtuar një vend e një komp që meriton dhëmpshërien e kujdonjeriu të ndrituar e të qytetëruar me ndjenja e vepra të njerinjtë”. “Qysh do të kenë sy e faqe francezët, - pyeste Vruoja, - të quhen bijtë e atyre burrave, të cilët, për të shpëtuar kombe nga robëria e nga tirania, derdhnin gjakun e shtrenjtë të tyre për të ujitur të shënjtën pemë të së hieruemes liri?”*<sup>12</sup>.

Ndërsa qëndrimi i diplomacisë franceze perceptohej të ishte i ngjashëm me atë të diplomacisë ruse, ai konsiderohej i ndryshëm nga qëndrimi britanik. Në ligjërimin e publicistit vlonjat D. Visos, pozicioni i Mbretëreshës së Deteve në çështjet e vogla, siç ishin ato ku *“përpiqeshin vetëm interesat e Shqipëriës me interesat e fqinjve te saj”*, konsiderohej si

<sup>9</sup> “I pari motmot i Shqipëniës së Re”, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit`i I, N. 32, 7/20 Dhetuar 1913, f. 2.

<sup>10</sup> “Na dhe Sërbët”! ..., f. 1-2.

<sup>11</sup> D. Viso, “Qysh punoi Anglia në çashtjen e Shqipëniës”, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit`i I, N. 28, Vlorë, 23/6 Vjesht` e III 1913, f. 1.

<sup>12</sup> Jani Vruho, “Mbledhja ambasadoriale dhe veprimet gjer më sot”, në *Liri e Shqipërisë*, Sofje, 24 maj 1913; A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha...*, f. 248-249.

“mesës/asnjanës” dhe “paqtues” mes Blloqeve. Në dallim, Franca “hyn në mes t’atyne që haen dhe s’kuptohen”, por nuk bën asgjë të ndryshme “nga puna q’ka bërë deri m’sot”. Ajo u tregua “armike” e krijimit të shtetit shqiptar, madje edhe kur “Fuqiët e tjera e venduan këtë krijim dhe ajo... e nënshkroi vendimin, ... luftën kundër të drejtave shqiptare e vazhdoi me tanë fuqiën e me të gjitha mjetet”<sup>13</sup>.

Në kumtin ligjërues të shqiptarëve, Franca vishej me përgjegjësi jo vetëm për copëtimin e territoreve, por me heshtjen e saj, edhe për sjelljen e fqinjëve karshi tyre. I ashpër në këtë aspekt ishte ligjërimi i korçarit Mihal Gramenos. Me tone të thukëta nacionaliste, të cilat përlligjeshin me zhgënjimin e thellë të shqiptarëve nga vendimi i Konferencës së Ambasadorëve për të shkëputur nga trungu amë Kosovën dhe Çamërinë, ai artikulonte si më poshtë:

*“Faji m’i madh [është] i Evropës e cila në Konferencë të Londrës nuku i zgjidhi gjithë çështjet me drejtësi e pa anë. Për shëmbël mi çështjen e Shqipërisë bëri gabime të mëdha, duke lënë dy pjesa të Shqipërisë në duart e Serbisë, Greqisë dhe Malit-Zi. Edhe këto gabime të pa ndjera u bënë mi kurris të Shqipërisë nga shkakut që Franca e Rusia pandehnin që Shqipëria gatuheshe për Austrinë me Italinë e kështu lanë të copëtohet midis shteteve të Ballkanit! Me gjithë këtë padrejtësi s’ju siguria të pakët jeta e të mjerëvet Shqipëtarë, që mbetën robër, po i lanë që me ma shumë sigurië Serbë, Grekë e Malëzës t’u djegin shtëpitë, t’i vrasin e t’i shtrëngojnë që të ikin nga atdheu i tyre i dashur. Vetëm ata që s’kanë shpirt e zemër njeriu munt të mos ngushëllojnë fatzinjtë Shqipëtarë...”<sup>14</sup>.*

Në vijim, Franca komentohej si gjegjësj kryesore në përcaktimin e papërshtatshëm të kufirit jugor të shtetit shqiptar. Përgjegjësia e saj me të drejtë artikulohej jo vetëm në tryezat diplomatike të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, por edhe për zvarritjen në terren të punës së Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit. Viso e konsideronte “nënën i idealeve” në binom të pandarë me Greqinë, që së bashku “s’duan t’i marrin përpara sysh të drejtat tona”<sup>15</sup>.

<sup>13</sup> D. Viso, “Qysh punoi Anglia në çashtjen e Shqipëniës” ..., f. 1.

<sup>14</sup> Mihal Grameno, “Ballkani Vullkan”! në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit i I, N. 15, 18/1 Vjeshtë e I 1913, f. 3.

<sup>15</sup> Po aty.

Me të njëjtën frymë kritike ndaj qëndrimit të diplomacisë franceze shkruante edhe Mehdi Frashëri, intelektual dhe politikan i spikatur. Në librin e tij *Problemet shqiptare*, të botuar 11 vite pas Shpalljes së Pavarësisë, Franca paraqitej si nismëtare ndër Fuqitë e Mëdha, në dëm të shqiptarëve në mbrojtje të helenizmit dhe të çështjes kombëtare greke. Në këtë kontekst, Frashëri nuk hezitonte ta konsideronte qëndrimin diplomatik francez, edhe më të zellshëm se atë rus.

*“Franca, që prej një shekulli e tëhu, shprehej ai, përhapjen e helenizmit e kishte bërë si një doktrinë politike kryesore të sajën në çështjen e Orientit e të Ballkanit. Kurdoherë që në tryezën e gjelbërt shtrohej një çështje që i takonte Greqisë dhe Shqipërisë, Quai d’Orsai edhe gjithë shtypi frëng, me zell e me nxehtësi mbronte Greqinë në dëm të Shqipërisë ....Më 1912, kur u bë fjalë për pavarësinë shqiptare edhe për kufinj të saj, Franca më shumë se Rusia mbronte interesat greke dhe serbe kundër Shqipërisë. Gjithashtu më 1913-1914 lëvizja epirote për të shkëputur Korçën dhe Gjirokastrën nga Shqipëria u shty edhe u përkrah nga ana e Rusisë, por më tepër nga ana e Francës”<sup>16</sup>.*

Por, kumti që japin ligjërimet e intelektualëve ndonëse, nga njëra anë kritikonte diplomacinë franceze që nuk merrte në konsideratë interesat e kombit shqiptar, nga ana tjetër i kujtonte asaj se shqiptarët ishin një komb i lashtë evropian, që kishin dhënë ndihmesën e tyre për mbrojtjen e Evropës, me aftësi shtetformuese, të cilët kishin nevojë për mbështetjen e Kontinentit të Vjetër dhe të Francës padyshim. Vihet re kështu një lloj artikulimi treplanësh si kritikë, kujtesë dhe thirrje për ndihmë (nevojë), njëkohësisht.

Ky lloj artikulimi ishte i dukshëm në ligjërimin e poetit nacionalist Gjergj Fishta. Në shkrimin e tij “A janë t’zot shqyptarët me u mbajt shtet m’vedi”, Fishta shprehej se:

*“Franca sodmesod asht një shtet nder ma t’fuqishmit t’Europës e se Shqypnija ka nevojë për n[d]i[h]më e simpati t’shteteve t’mëdha. Me arsye n’dorë duem me u diftue.... se nuk asht e vërtetë qi shqyptarët janë një racë barbare, një kom qi nuk mundet me u mbajtë shtet m’vedi...., pse na dishrojmë qi francezët e njerzishëm t’mendojnë mirë për ne, e t’kenë simpati për një popull qi sod s’parit, si shtet m’vedi, asht tuj u vu për udhë t’përparimit”<sup>17</sup>.*

<sup>16</sup> Mehdi Frashëri, *Problemet shqiptare*, Tiranë: Liria, 2001, f. 58.

<sup>17</sup> Gjergj Fishta, “A janë t’zot shqyptarët me u mbajt shtet m’vedi”, në Ndrëçim Kulla, *Antologji e mendimit shqiptar 1870-1945*, Tiranë: Plejad, 2003, f. 156.

Për sa më sipër, ai i bënte thirrje Francës t’i mbështeste shqiptarët dhe të mos ia lëshonte “*sllavve t’Ballkanit n’dorë për me i zbutë e me i gjytetnue*”.

Ndërkohë që një diskurs me tone më të zbutura dhe doza optimizmi, vihet re në ligjërimin e jashtëm\* të shqiptarëve. Kjo formë ligjërimi, që i shkon për shtat diplomacisë, vihet re në memorandumun që Qeveria e Përkohshme e Vlorës i dërgoi Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 2 janar 1913. Në të evidentohet fakti se shqiptarët ishin banorë të hershëm të Gadishullit Ballkanik, të cilët shprehnin bindjen se Fuqitë e Mëdha, pjesë e të cilave ishte edhe Franca, do të ndihmonin për respektimin e përpiktë të parimeve themelore në caktimin e kufijve të shtetit të tyre. Tonet e optimizmit dhe të besimit tek Fuqitë e Mëdha artikulohehin qartë, veçanërisht në pjesët përmbyllëse të memorandumit. Sipas tyre, Europa nuk mund të qëndronte indiferente “*kundrejt kërkesave të drejta të një kombi të denjë për të pasur një fat më të mirë, që ka vuajtur në të kaluarën dhe që ka besimin më të thellë dhe shpresat më të shtrenjta në të ardhmen e tij*”. Shqipëria pa mëdyshje dëshironte “*të bashkëpunojë në veprën e përparimit botëror dhe të zërë vendin e saj në bashkësinë e popujve të qytetëruar*”, por për t’ia dalë dhe për ta merituar një vend të tillë, ajo kërkonte “*me këmbëngulje garanci nga Fuqitë e Mëdha*”<sup>18</sup>.

Shpallja e Pavarësisë dhe krijimi i shtetit u ofroi elitave politike e intelektuale shqiptare shansin për të zbatuar eksperimentin e modernizimit të Shqipërisë. Ligjërimi modernist shtetëror filloi e zuri vend në shkrimet e kohës, ndërkohë që modeli shtetëror francez u bë pjesë e tij.

Franca me të drejtë konsiderohej kombi i lirë që i kishte treguar gjithë botës se “*e drejta e njeriut ekziston*” dhe se “*njeri është e duhet të*

\* Në këtë artikull termi “ligjërim i jashtëm” përdoret në kuptimin e ligjërimin që Qeveria e Përkohshme e Vlorës përdorte jashtë shtetit, në raport me Fuqitë e Mëdha.

<sup>18</sup> *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912-22 janar 1914)*, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të R.P.SH, Tiranë: Mihal Duri, 1963, f. 98-100. Memorandum i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dërguar Konferencës së Ambasadorëve në Londër, 2 janar 1913.

*jetojë i lirë*<sup>19</sup>; kombi i madh, liberal e i lavdishmëm që me Revolucionin Francez kishte “*rrëfyë e dëftejnë ma të madhin kuxim trimerisht, ma të madhin durim burrërisht*”. Pikërisht, Revolucioni Francez duhej t’i shërbente si model shqiptarëve dhe veçanërisht të rinjve, për ta lartësuar Shqipërinë, ashtu sikurse francezët kishin bërë me Francën. Ja si shprehej Emin Matraxhiu në vitin 1913:

*“Të rinjt e kombëdashësit, vetëm ata e shpëtuanë Francën, të cilët duke u armatuar kundrejt dëshpërimit, dëbuar përtimin, atë armikun të njerzimit, i cili i poshtëron e varfëron popujt që fut në lak të tij, punuanë me shpres të pa tundur fituan të drejtat njerëzore edhe e lartësuanë Francën në këtë shkallë të cilën e kanë zilië bota”*<sup>20</sup>.

Në kumtin ligjërues, Franca konsiderohej si modeli që duhej ndjekur edhe sa i përket zhvillimit të shkencës e të letërsisë, si edhe rëndësisë që duhej t’i jepej gjuhës kombëtare. Kështu në shkrimin botuar në *Përlindja e Shqipëniës*, më 10 shtator 1913 hiqeshin paralele mes mënyrës sesi francezët ishin kujdesur për frëngjishten dhe mënyrës sesi shqiptarët duhej të trajtonin shqipen, gjuhën e tyre amtare. Gjuha ishte ajo, që e kishte

*“naltësuar Francën kombërisht dhe mbrodhësisht. Një komb me një gjuhë kaq të begacime dhe të plotë s’vdes, s’humbet kurë, se një komp me kaq përparim ka siguruar qenien e tij moralisht në qoftë se humbet materialisht. Francasit... dit e natë përpiqen nëpër akademië të zbukurojnë literaturën, ...i madh e i vogël nderon gjuhën si nderin e tij, ushqen një dashuri si për shpirtin e tij. Këtë komp s’e tremp gjësendi në botë së s’ka lënë gjë të metë”*<sup>21</sup>.

Mbrojtja e zhvillimi i gjuhës kombëtare konsiderohej si “*një peshë që ndan të shumen nga e paka*”. Artikullshkruesi i bënte thirrje opinionit

<sup>19</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar (1918-1920)*, (përmbledhje dokumentesh), përgatitur nga Muin Çami, Hidajete Luga (Bejtja) në bashkëpunim me Dhimitër Andonin, Mediha Shuteriqin dhe Zekeria Rexhën, Tiranë: Mihal Duri, 1975, f. 54-55. Letër nga Shkodra për kolonelin francez, B. De Furtu, Shkodër, 17 nëntor 1918.

<sup>20</sup> Emin Matraxhiu, “Dëshpërimi. Përtimi”, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit`i I, Vlorë, N. 9, 24/10 Vjesht` e I 1913, f. 2.

<sup>21</sup> “Shqipëtarë jemi, gjuhën s’e dimë”!, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit`i I, N. 11, Vlorë, 4/17 Vjesht` e I 1913, f. 4.

publik dhe instancave qeveritare të kujdeseshin për shqipen, në të njëjtën mënyrë sikurse francezët për frëngjishten.

Franca konsiderohej një model i vlefshëm edhe sa i përket legjislacionit. Duke shpërfillur qëndrimin e diplomacisë, legjislacionit francez i jepej e njëjta qasje pozitive sikurse legjislacionit të Italisë e të Austro-Hungarisë, dy fuqitë mbështetëse të kauzës shqiptare:

*“...Shqipëria, si Shtet european, lipset të ketë dhe kanune gjith’ ashtu europianë. Shteti ynë, duke parë se ligjet e trashëguara prej Turqisë janë shumë të vjetra dhe nuk na e mbushin nevojën e kohës së sotme, vendosi dhe formoj një komision prej juristësh për të përgatitur ligje të reja”<sup>22</sup>.*

Për një pjesë të tyre, si model artikulohej Kodi Penal, Kodi Tregtar dhe ai Civil francez<sup>23</sup>.

Karakterit dual në perceptimin e përgjithshëm të shqiptarëve për Francën, mori tone të njësuara në rastin e korçarëve, atëherë kur politika në terren e ushtarakëve francezë, në kuadrin e Luftës së Parë Botërore, i dha jetë Krahinës Autonome të Korçës. Ndonëse kjo natyrë perceptimi, është e krijuar në kushte lufte, ajo shkon në unison me përfundimin se perceptimi i shqiptarëve karshi Francës nuk ishte statik, por kushtëzohej nga sjellja dhe politika që francezët ndiqnin karshi tyre.

### **Një vështrim mbi politikën në terren të ushtarakëve francezë, krijimin dhe drejtimin e Krahinës Autonome e Korçës<sup>24</sup>**

*“Shumë lehtë e kupton se ke të bësh me një popullsi që kërkon rrugën e vet ..., ajo kërkon pavarësinë. .... Detyra [jonë] nuk është e lehtë: duhet*

<sup>22</sup> Kristo Floqi, “Gjyqësia në Shqipërië”!, në *Përlindja e Shqipëniës*, Vit’i I, N. 20, Vlorë, 5/18 Vjesht’ e II 1913, f. 4.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Për një trajtim të detajuar në lidhje me Krahinën Autonome të Korçës dhe politikën e ndjekur nga ushtarakët dhe diplomatët francezë shih: Muin Çami, *Shqiptarët dhe francezët në Korçë (1916-1920)*, Tiranë: Dituria, 1999; Renaud Dorlhiac, *Les territoires albanais sous administration française (1916-1920)*, mémoire de DEA sous la direction de Gilles Veinstein, EHSS, 1999.

*bërë që të funksionojë vendi, të sigurohet jeta e secilit dhe të mbretërojë rendi ... e mbi të gjitha që ta duan Francën, duke përhapur arsimin”<sup>25</sup>.*

Ky ishte opinioni i kolonelit francez André Odrion (Andre Odrion) për shqiptarët e Korçës dhe për politikën sesi francezët duhej të administrojnë territorin juglindor të Shqipërisë, një vit pasi ushtria franceze e kishte shkelur atë. Ideator i kësaj politike kishte qenë koloneli Henri Descoins (Henri Dekuë), i mbështetur fort nga gjenerali Maurice Sarrail (Moris Sarej), kryekomandant i Përgjithshëm i Armatës së Orientit. Strategjia e tyre, krahas nevojave ushtarake të luftës, ishte në funksion të asaj që për ushtarakët francezë konsiderohej si “pushtim moral”<sup>26</sup>.

Kjo strategji, që padyshim mbartte edhe karakter demagogjik, i shkonte përshtat rrethanave së Luftës së Parë Botërore, në funksion të fitimit të simpatisë së korçarëve. Gjenerali Salle, komandant ushtarak i qarkut të Korçës, në fjalimin e mbajtur, më 14 korrik 1917 në kishën e Shën Gjergjit, me rastin e kremtimeve të festës kombëtare të Francës, trumbetonte:

*“Ne ushtarët e Francës po luftojmë për të përhapur në botë fjalët e “Lirisë, Barazisë, Vëllazërisë”, fjalë të cilat janë të shkruara me shkronja të florinjta mbi flamurin tonë”<sup>27</sup>.*

<sup>25</sup> Një oficer francez në Ballkan (1917-1925), Vëllimi I (Shqipëria dhe Maqedonia), Shkrime të kolonelit Andre Ordion, paraqitur nga i nipi, Dominique Danguy des Deserts, Tiranë: Papyrus, 2014, f. 19. Letër e kolonelit Andre Ordion për të shoqen Mari Quinquet de Monjour, Korçë, 29 nëntor 1917.

<sup>26</sup> Po aty, f. 360. Administrata franceze në kufijtë shqiptarë (1917-1920). Raport i kolonelit francez Odrion, Korçë, më 12 gusht 1924.

Në këndvështrimin e studiueses Nina Salouâ Studer koncepti i “pushtimit moral” ishte një koncept kolonialist, që kishte të bënte me obligimin që Franca si një shtet superior, kishte ndaj kolonive të saj për të siguruar kushte më të mira nëpërmjet dominimit kulturor e arsimor. Shih Nina Salouâ Studer, *The Hidden Patients: North African Women in French Colonial Psychiatry*, Böhlau Verlag GmbH & Cie, Köln Weimar Wien, 2016, f. 12.

<sup>27</sup> Fjalimi i gjeneralit francez vijonte me tone patetike: “Neve nga anët tona do tu mbrojmë, po u sigurojmë që asnjë njeri nuk do t’u trzojë, as juve vetë as mallin tuaj, po ju sjellim qetësinë të cilën më të shumtin herë nuk e keni patur, me një fjalë po ju japim çdo gjë që ju duhet që të përparoni të çliruar. Si ushtarë të së lirës Francë nuk kemi tjetër qëllim, dhe kësaj është kudo që vemi neve. Kini pra besim ndër ne, sikundër kemi edhe ne besim ndër ju. Punoni, jini Aleatë besnikë

Kështu, në funksion të “pushtimit moral” sigurimi i arsimit publik falas dhe të detyrueshëm u konceptua si një nga shtyllat në politikën e ushtarakëve francezë në Shqipëri. Krahas punimeve publike në fushën e dobisë ushtarake, vendosjes së rendit dhe qetësisë, transmetimit të parimeve të higjienës publike, nëpërmjet arsimimit të popullsisë, ushtria nxiti veprimtarinë intelektuale që kishte si qëllim ta bërë Francën të njohur tek opinioni publik shqiptar. Në pikëpamjen morale, ajo kishte si qëllim të rriste prestigjin dhe të mbante të paprekur influencën franceze në zonën e pushtuar dhe të brumosjes së rinisë korçare me dashurinë për Francën<sup>28</sup>.

Pa anashkaluar përhapjen e influencës franceze në pjesën aziatike të Perandorisë Osmane, nevoja e një politike të re në Ballkanin e përflakur nga Lufta Botërore, ndjehej në radhët e ushtarakëve francezë. E ndodhur midis Lindjes dhe Perëndimit, Shqipëria mund të luante një rol të rëndësishëm për pozicionin gjeografik që kishte, thujse në një kryqëzim të pashmangshëm të influencave austro-hungareze dhe italiane. Kjo politikë e motivuar nga zhvillimet e Luftës së Parë Botërore, shërbeu si një shkëndijë në dobi të një “pajtimit” të kushtëzuar dhe të përkohshëm, midis autoriteteve ushtarake franceze dhe shqiptarëve të Korçës.

Në të gjithë arealin shqiptar, zona e Korçës, gjeografikisht shumë afër me frontin e Selanikut dhe në kufi me zonën austro-bullgare dhe italiane, shërben si një “key studies”, sepse pikërisht aty u jetësua “pajtimit” i përkohshëm midis francezëve dhe shqiptarëve. Nuk është e vështirë të kuptosh se me krijimin e Krahinës Autonome të Korçës, më 10 dhjetor 1916, koloneli Descoins mbajti anën e shqiptarëve, duke u mbështetur tek ata në administrimin e krahinës. Nëpunësit grekë, të cilët ndodheshin aty

*dhe do ta kuptoni që nën mbrojtjen e armëve tona, vendi juaj kaq i bukur do të jetë prapë i lumtur, se këtij vendi natyra i ka dhënë kaq dhurata të bukura. Natyra i ka dhënë vendit tuaj dhëra të begaçme, ujra me të tepërt, male të mëdhenj, bakër, qymyr guri të cilat bëjnë një vend të pasur. Është në dorën tuaj që me punën tuaj ti nxirrni këto begati nga dheu juaj”. “Fjalimi që mbajti datën e 14 Korikut 1917 në kishën e Shën Gjergjit, z. Gjeneral Salle, komandant i qarkut ushtarak të Korçës, duke iu përgjigjur në fjalimet e kryetarit të Shoqërisë Kombëtare “Përparimi” dhe të Sekretarit të Këshillës Qeveritare”, *Gazet’ e Korçës, Vit’ i I, Numër 71, Korçë e enjte, 6/19 Korik 1917, f. 2.**

<sup>28</sup> *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)...*, f. 352-376. Administrata franceze në kufijtë shqiptarë (1917-1920). Raport i kolonelit francez Odrion, Korçë, më 12 gusht 1924.

që prej tetorit të 1914-ës, lanë qytetin duke marrë me vete arkivat dhe kursimet që kishin bërë<sup>29</sup>. Një bërthamë e vogël nëpunësish francezë dhe shqiptarë i zëvendësoi dhe iu vu punës për administrimin e zonës. U ul flamuri grek dhe vendin e tij e zuri flamuri shqiptar, me shiritin tringjyrësh francez.

Në kushtet e Luftës së Parë Botërore, ky veprim i siguroi francezëve qetësinë në krahun perëndimor të frontit të Selanikut, përqendrimin në ofensivën e Manastirit, furnizimin me ushqime dhe vullnetarë shqiptarë, si edhe mbajtjen larg të austro-hungarezëve dhe italianëve, të cilët pretendonin të futeshin në Korçë dhe zonat përreth. Nga ana tjetër, duke krijuar Republikën Autonome të Korçës, koloneli francez ishte ngutur të krijonte një atmosferë të favorshme për “pushtimin moral”, të cilin dhe nëse nuk e kishte arritur me një goditje të vetme, kishte hedhur farën e tij. Në kujtimet e botuara në vitin 1930, koloneli Descoins nuk hezitonte të shprehte bindjen se:

*“të mëkëmburit e Shqipërisë me ndihmën e Francës do të vazhdonte nga lufta në paqe, për arsye se vendi i tij nuk mund të paditej për asnjë paramendim imperialist; Franca nuk kishte si të lëndonte ndjenjën e lirisë që në zemrat shqiptare zotëronte mbi çdo ndjenjë tjetër”<sup>30</sup>.*

Më 12 dhjetor 1916, vetëm dy ditë pas nënshkrimit të Protokollit për krijimin e Krahinës Autonome të Korçës, në mbështetje të nenit VIII të tij, “*Gazet’ e Korçës*” në faqen e parë të saj pasqyroi vendimin e kolonelit Descoins, sipas të cilit “*gjuha oficiale e Vetqeverisë së kazasë Korçës do të jetë që sot dhe pas kësaj Shqipja. Këjo gjuhë duhet të përdoret për të gjitha punërat Qeveritare (për gjyqe, kërkime, kontrato, etj)*”<sup>31</sup>. Vendimi ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në çështjen e

<sup>29</sup> *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*..., f. 361. Administrata franceze në kufijtë shqiptarë (1917-1920), Korçë, më 12 gusht 1924.

<sup>30</sup> Xavier de Courville, “Historia e Liceut të Korçës”, në *Lyceum*, Viti i I, No i vetmë, korrik 1936, Korçë: Shtypshkronja Dhorë Koti, 1936, f. 11-12; Niko Bello, “Liceu Kombëtar i Korçës”, në *Korça e re*. Almanak i Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për Korçën, Nr. 5, Korçë: 1964, f. 139.

<sup>31</sup> *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i II, Numër (81)/1, Korçë 29/12 Deqember 1916, f. 1.

Vendimi u pasua nga një urdhër i policisë shqiptare, datë 7 shkurt 1917, sipas të cilit “Urdhërohen gjithë tregtarët si dhe të tjerët pas mjeshtërisë që kanë të rrezojnë tabelat q’i kanë shkruar me gjuhë të huaj dhe t’i shkruajnë në gjuhën anëtare [nënkupto: amtare]. Janë liruar të shtojnë në tabelat (ata që duan) dhe

shkollave në zonë<sup>32</sup>. Të paktën deri në maj të 1917-ës, kohë kur koloneli u largua nga Korça, nuk vihet re një vullnet i ushtarakëve francezë për të zbutur raportet me grekët, sa i përket kësaj çështjeje dhe për të acaruar marrëdhëniet me shqiptarët. Dëshira e shprehur e korçarëve për t’u arsimuar në gjuhën shqipe dhe mungesa e simpatisë ndër ta për të kaluar nën dominimin grek, edhe pse një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ortodokse të qytetit reflektonte një kulturë të përkorë nga helenizmi, konsideroheshin si argumente thelbësore në qëndrimin e mbajtur nga ushtarakët francezë<sup>33</sup>. Sipas konsullit francez në Selanik, de Billy “popullsia e Korçës dëshiron ngrohtësisht të heqë qafe grekët, që shkatërruan vendin..., ajo dëshiron të ruajë karakterin shqiptar me një autonomi deri në fund të luftës”<sup>34</sup>.

Në të tillë situatë, veprimi i radhës i autoriteteve vendore kishte të bënte me mbylljen e shkollave greke<sup>35</sup>, të cilat u konsideruan si mjete

gjuhën Frëngjishte”. Shih: *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i II, Numër (128) 38, Korçë 25/7 shkurt 1917, f. 2.

<sup>32</sup> Të paktën që nga gjysma e dytë e shek. XIX, zona e Korçës ndjente influencën greke, ku evidentohet ndikimi I SHKOLLËS DHE KULTURËS GREKE. Njëpërmjet arsimimit të popullsisë në shkollat në gjuhën greke dhe propagandës kulturore, Greqia në vazhdimësi kishte synuar kultivimin e një identiteti helen në radhët e popullsisë ortodokse korçare. Me rritjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe pas 1912-ës me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, Korça mbeti vend ku helenizmi u përball me shqiptarizmin, por pa e fituar betejën me të. Në këtë kontekst, çështja e shkollave nuk kishte të bënte thjesht me aspektin edukativ të popullsisë. Ajo ishte më tepër se kaq, ishte pjesë integrale e çështjeve kombëtare përkatëse, çka e bënte të pashmangshme edhe përballjen mes shkollave shqiptare dhe atyre në gjuhën greke. Për më shumë në lidhje me influencën dhe propagandën greke në Shqipërinë e Jugut shih: L. Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj...*, f. 23-30.

<sup>33</sup> *Një oficer francez në Ballkan (1917-1925)*..., f. 38. Letër e kolonelit Andre Ordion për të shoqen Mari Quinquet de Monjour, Korçë, 27 mars 1918.

<sup>34</sup> M. Çami, *Shqiptarët dhe francezët në Korçë...*, f. 166-167. Telegram i konsullit francez në Selanik, që Biji drejtuar Ministrisë Franceze të Punëve të Jashtme, Selanik, 23 janar 1917.

<sup>35</sup> Sipas relacionit që Ministria e Jashtme i dërgoi legatës në Paris, në çastin e pushtimit nga ushtria franceze, në shkollat e Korçës edukoheshin 600 nxënës të të dyja gjinive, ndërsa në rrethinat e qytetit funksiononin 120 shkolla me 12.000 nxënës. *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές Σχέσεις*, Επιμέλεια: Βασίλειος, Κόντης, Έγγραφα από το Ιστορικό Αρχείο του Υπουργείου

propagande, që prishnin qetësinë e vendit. “Pasi i rëshqitnë nga dora patronazhit helenik, ishte afër mendsh që shqipëtarët e Korçës do të kërkonin që rinia e vendit të rritesh shqipëtarë”, shprehej në vitin 1936, Xavier de Courville, drejtor i Liceut Francez<sup>36</sup>. Në mars të 1917-ës, këshilli administrativ i Krahinës Autonome të Korçës, pas propozimit të Descoins-it\*, vendosi të lejonte vetëm funksionimin e institucioneve arsimore shqiptare, arsimit për fëmijët nga 7 deri 12 vjeç të ishte i detyrueshëm, ndërkohë u përpilua edhe rregullorja përkatëse. Në zbatim të vendimit, shkollat në gjuhën greke, përfshirë këtu edhe Gjimnazin Grek<sup>37</sup> dhe Shkollën e Vajzave, u mbyllën, veprim ky që i dha karakter kombëtar shqiptar, arsimin në Korçë. Në vazhdimësi të vendimeve me karakter arsimor, më 5 prill 1917 u krijua edhe Drejtoria Arsimore<sup>38</sup>.

Εξωτερικών, Τόμος Ι (1897-1918), Αθήνα: Εστιασ, 2004, f. 393. Ministria e Jashtme për ambasadën e Parisit, Athinë, 29 gusht 1917.

<sup>36</sup> X. de Courville, “Historia e Liceut të Korçës...”, f. 10.

\* Komandanti ushtarak francez i qarkut të Korçës kishte kontrollin mbi të gjitha mekanizmat administrativë. Disiplina, arsimit i përgjithshëm, administrata publike vareshin nga koloneli Descoins, i cili kishte përgjegjësinë për gjithçka.

<sup>37</sup> Gjimnazi Grek, e vetmja shkollë serioze e mesme mashkullore në Korçë, ishte themeluar në vitin 1856. Ai e kishte plotësuar ciklin prej 6 klasash, nga e 7-ta deri në të 12-tën, vetëm në vitin 1889. Gjimnazi mbahej kryesisht nga donacionet e fondit Lasso, një fond i komunitetit lokal që mbështeste krijimin dhe funksionimin e shkollave greke në Korçë. Kontribuuesi kryesor i këtij fondi ishte Ioanis Pangas, emrin e të cilit gjimnazi mori në vitin 1895, pas vdekjes së tij. Nxënësit ishin kryesisht të besimit ortodoks, 70% e të cilëve vinin nga Korça dhe pjesa tjetër nga zonat përreth. Programi i shkollës mbikëqyrej nga Komiteti për Mbështetjen e Edukimit grek dhe kishës ortodokse. Përgjithësisht, trupa pedagogjike e gjimnazit ishte shkolluar në Universitetin e Athinës. Për më shumë në lidhje me Gjimnazin Grek dhe donacionet e fondit Lasso shih: *Adelais Ismirliadou*, “Educational and Economic Activities in the Greek Community of Koritsa during the second half of the nineteenth century”, *Balkan Studies*, no. 37, Selanik, 1996. Konsultuar në: [ojs.lib.uom.gr/index.php/BalkanStudies/article/view/2807](https://ojs.lib.uom.gr/index.php/BalkanStudies/article/view/2807) (data e klikimit, 22 nëntor 2016); *Greek lands in history, Epirus, 4000 years of Greek history and civilization*, Editor: M.B. Sakellariou, Ekdotike Athenon S.A. Athens: The Demetrius and Egle Botzaris Foundation, 1997.

<sup>38</sup> Stefan Popescu, “Les Français et la République de Kortcha”, *Guerres mondiales et conflits contemporains*, 2004/1 (no. 213), Presses Universitaires de France, f. 84.

Artikulli është konsultuar në: <https://www.cairn.info/revue-guerres-mondiales-et-conflits-contemporains-2004-1.htm>, datë 16 nëntor 2017.

Shpejt u hapën dhjetëra shkolla fillore shqiptare, që u frekuentuan nga një numër i konsiderueshëm nxënësish<sup>39</sup>. Organizimi i tyre u bë në shkallë të gjerë. Çdo fshat kishte shkollën e tij dhe nga komanda ushtarake u urdhërua rishtypja e një abetareje të vogël që i përkiste vitit 1911. Në orët e mësimi u vendos mësimi i frëngjishtes<sup>40</sup>.

Në mes të kësaj atmosfere, në vjeshtë të 1917-ës u hap Liceu Francez, një ide e hershme e kolonelit Descoins, e mbështetur fort nga Këshilli Administrativ i Krahinës. Liceu që në krijimin e tij funksionoi si një shkollë e mesme kombëtare, laike, e përbashkët për ortodoksët dhe myslimanët, që nuk varej nga institucionet fetare. Interesi për hapjen e tij ishte i dyanshëm: për shqiptarët Liceu plotësonte boshllëkun e krijuar nga mbyllja e Gjimnazit Grek, të rinjtë formoheshin larg influencës greke, të cilën me të drejtë e kishin parë si një rrezik për ndjenjën kombëtare, ndërkohë që arsimi në Korçë fitonte një tipar të ri, atë perëndimor. Për francezët Liceu, i siguronte Francës jo vetëm në kohë lufte, por edhe në kohë paqeje bazat për përhapjen e kulturës dhe të ndikimit të saj në Shqipëri, pra të "pushtimit moral".

### **Tonet e njësuara në perceptimin e korçarëve për Francën**

Politika e përvijuar nga koloneli Descoins në dobi të strategjisë së "afirmimit kombëtar" dhe ngritjes së strukturave shqiptare e laike; mbyllja e shkollave greke dhe hapja e Liceut Francez i dha shpejt frytet e veta. Perceptimi i shqiptarëve në Korçë për francezët ndryshoi, duke mënjanuar dualizmin, që më së fundmi merrte shkas nga qëndrimi negativ i diplomacisë franceze në Konferencën e Ambasadorëve në

<sup>39</sup> N. Bello, "Liceu Kombëtar i Korçës...", f. 137.

Në vitin 1920, kur francezët u larguan nga Korça, aty funksiononin 200 shkolla fillore që zhvillonin mësim në gjuhën shqipe. Shih: X. de Courville, "Historia e Liceut të Korçës...", f. 12; Guillaume Robert, "L'Albanie et la France dans l'entre-deux-guerres: une relation privilégiée? La présence culturelle française en Albanie, entre mythe et réalité", *Balkanologie*, Vol. II, no.2, December 1998.

Artikulli është konsultuar në <http://balkanologie.revues.org/index261.htm> (datë 5 dhjetor 2016).

<sup>40</sup> Luan Rama, *Bon Jour d-Albanie (shkrime nën hijen e bombave)*, Les livres Rama, Tiranë: Shtypshkronja Maluka, 2014, f. 35. Korrespondenti francez i luftës, Robert Vaucher shkruan nga Korça, 28 shkurt 1917.

Londër. Nga mike e Greqisë, armikut tradicional të shqiptarëve<sup>41</sup>, pas shpalljes së Krahinës Autonome, Franca u konsiderua nga korçarët si “liridhënësja”, “motra e madhe dhe e nderuar”, besnike në premtimet e saj, që

*“pasi na shpëtoi nga armiqtë tanë tradicionalë na dha lirinë, dhe proklamoi vetëqeverimin tonë kombëtar të cilin e morën nën mbrojtjen e tyre të lartë, [ushtarakët francezë]”<sup>42</sup>.*

Në një situatë të tillë nuk munguan edhe tone patetike dhe demagogjike në ligjërimin e kohës, me anë të të cilit i bëhet thirrje shqiptarëve për dashuri të pakusht ndaj Francës. Ja si i drejtohej bashkatdhetarëve të tij Petro Harizi, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Qeveritar të Republikës Shqiptare të Korçës

*“Të duam këtë të nderçmë Komb Francez i cili na mbush me kaq mirëbesim, të lutemi për Atë dhe Aliatët për fitore të plotë, për triumfin e së drejtave të njerëzies edhe të drejtësisë së përgjithshme, edhe të thershim “Rroft e nalta Nënë e lirive botës, roftë mbrojtësja*

<sup>41</sup> Korrespondenti francez i luftës, Robert Vaucher në reportazhin e bërë nga Korça, më 28 shkurt 1917, e përshkruan kështu perceptimin që shqiptarët kishin për Francën para dhe pas krijimit të Krahinës Autonome të Korçës: “Në sytë e nacionalistëve shqiptarë, Franca njihej si pro-helene. Kur një oficer francez diskutoi me Sali Butkën, duke i thënë se përse luftonte kundër francezëve, ai i ishte përgjigjur: “Në Konferencën e Londrës, Franca ishte kundër vendit tim. Ajo kërkoi t’i jepeshin Greqisë sa më shumë territore të Shqipërisë Jugore... Unë mbërrita në Korçë dy muaj pas shpalljes së Republikës dhe ngado, si nga myslimanët ashtu edhe nga të krishterët dëgjova veç zëra mirënjohjeje ndaj Francës”. Shih: L. Rama, *Bon Jour d-Albanie ...*, f. 33-34. Korrespondenti francez i luftës, Robert Vaucher shkruan nga Korça, 28 shkurt 1917.

<sup>42</sup> “Fjalë panegjirike. E thënë prej z. P. Harisiadhiti, sekretar gjeneral i Këshillës Qeveritare të Republikës Shqipëtare, në Kishën e Shën Gjergjit pas lutjes së kremtimit të 14 Korikut”, në *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i I, Numër 71, Korçë e enjte 6/19 Korik 1917, f. 1-2.

Në lidhje me perceptimin e shqiptarëve për francezët shih edhe: P. H[arisiadhi], “Nderim ne koloneli Descoins, dhe lavdim ne Franca”, në *Adriatiku*, Mot’i I, Nr. 6, Korçë, 12 dhjetor 1916; “Katër gazetarë të mëdhej francezë në Korçë”, në *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i II, Numër (139) 49, Korçë, 24/9 mars 1917, f. 1; “Kllupi “Përparimi”, në *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i I, Numër 52, Korçë, 11/24 Maj 1917, f. 2; “Fjalim i thënë prej Direktorit të Arsimit si edhe kryetarit të Shoqërisë kombëtare “Përparimi” më 14 Korik 1917 në Kishë të Shën Gjergjit”, në *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i I, Numër 71, Korçë, 6/19 Korik 1917, f. 1.

*e madhe e popujve të shtenguar, roftë Franca e pavdekurë, rofshin Aliatët e mëdhenj”<sup>43</sup>*

Me tone patetike, shprehje hiperbolike për Francën dhe oficerët francezë ishte i veshur edhe ligjërimi i shqiptarëve të Amerikës, me origjinë nga Korça. Në shkrimin “Korcha Madhështore edhe Franca liberale”, botuar në gazetën *Përparimi*, të New York-ut, K. Demo e konsideronte Francën “liberale”, “të qytetëruar” dhe “chlironjëse të kombeve të vegjël”. Ai u bënte thirrje korçarëve të ishin mirënjohës karshi oficerëve francezë për çlirimin nga “errësira greke” dhe me zgjuarsi të përfitonin nga liria e qytetërimi, që Franca u ofronte.

*“O popull trim i Korches merrni erë liri të paqme, sallutoni Francën liberale, sallutoni Francën e qytetëruar e cila kur do herë është përpjekur për çlirimin e kombeve vegjël. Sot erdhi rasti mi mirë që epa vetë vendin’e Skënderbeut atë popull liri dashës, i cili është përpjekur për lirinë e vet me gjithë fuqi, nga që kundrestarët tanë qenë më të fortë, dhe nuk na linin të përparonim ...”<sup>44</sup>.*

Shkrimi shoqërohej edhe me një gravurë në të cilën Korça dhe Franca paraqiteshin si dy zonja/motra në krah të njëra-tjetrës. Korça, më e re në moshë, tejet krenare, që kishte nevojë për mbështetjen e Francës; kjo e fundit e pjekur, madhështore dhe me qëndrim të dukshëm mbrojtës karshi Korçës/motrës së vogël. Gravura shoqërohej me diçiturën e cila ishte një dialog midis Francës dhe Korçës: “*Franca: Ngreu dhe miaft ndenjen ne Roberi. Korcha: U ngrita, po kam nevojë per ndihme*”.<sup>45</sup>

<sup>43</sup> “Fjalë panegjirike. E thënë prej z. P. Harisiadhrit, sekretar gjeneral i Këshillës Qeveritare të Republikës Shqipëtare, në Kishën e Shën Gjergjit pas lutjes së kremtimit të 14 Korikut”, në *Gazet’ e Korçës*, Vit’ i I, Numër 71, Korçë, 6/19 Korik 1917, f. 1-2.

<sup>44</sup> K. T. Demo, “Korcha Madhështore edhe Franca Liberale”, në *Përparimi*, Vol. II, No. 10, New York, March 1917, f. 6; Kaliopi Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve “Adriatiku” dhe “Gazet’e Korçës” (Dhjetor 1916 - gusht 1918)*, Trajtesë dhe dokumente, Tiranë: Kristalina-KH, 2017, f. 32.

<sup>45</sup> *Po aty*.



Ndërsa poeti korçar, emigrant në Amerikë, Zisi Stratobërdha në poezinë e tij *Korcha qytet i bukur*, botuar sërisht në gazetën *Përparimi*, shprehej:

*...Edhe Franca Liberale  
Mbrenda mune kordhe vate  
Ngriti flamur dykrenor  
Shqipërinë e kujtoj*

*Poshtë poshtë rrobëria  
Sot na u cipal Liria  
Me ch' do chip valon flamuri  
Thrisni roftë Shqipëria...<sup>46</sup>*

<sup>46</sup> Zisi Stratobërdha, “Korcha qytet i bukur”, në *Përparimi*, Vol. II, No. 1, New York, June 1917, f. 26.

### Sërish dualizëm në perceptimin për Francën

Qasja me tone të njësuara në perceptimin e shqiptarëve të Korçës për “motrën e madhe” nuk vazhdoi gjatë. Arsyet i gjejmë sërish tek politika franceze. Që në momentet e para të krijimit të Krahinës Autonome të Korçës u krijua një mosmarrëveshje midis komandës së “Armatës së Lindjes” në Selanik dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës. Kjo e fundit nuk u tërhoq nga qëndrimi tradicional francez karshi shqiptarëve, i shprehur si në Konferencën e Ambasadorëve të 1913-ës, edhe në Traktatin e Fshehtë të Londrës, në prill 1915, ku Franca kishte mbështetur pretendimet dhe interesat e fqinjëve të Shqipërisë.

Ndërkohë mosmarrëveshjet mes diplomatëve dhe ushtarakëve francezë erdhën duke u thelluar përgjatë vitit 1917 për disa arsye: për shkak të vetë zhvillimeve në kazanë e Korçës, të ankesave e të pretendimeve të Esat Pashë Toptanit dhe të thellimit të presioneve të Romës dhe Athinës në Paris<sup>47</sup>. Këto arsye në tërësinë e tyre ndikuan që Ministria e Punëve të Jashtme ta cilësonte shpalljen e Krahinës Autonome të Korçës si një “incident” që duhej shmangur, duke kërkuar zyrtarisht më 17 tetor 1917 abrogimin e protokollit të 10 dhjetorit 1916<sup>48</sup>. Në këtë mënyrë “pajtimi” mes francezëve dhe shqiptarëve, i kushtëzuar nga rrethanat e Luftës së Madhe, do të rezultojë i përkohshëm.

Më 1 nëntor 1917 Themistokli Gërmenji, figura kryesore e administratës shqiptare të Krahinës Autonome të Korçës, që gëzonte popullaritet të madh ndër shqiptarë, i dekoruar me dekoratën e lartë franceze të “Kryqit të Luftës”, u arrestua nga organet e sigurisë së forcave ushtarake franceze nën akuzën e agjentit në shërbim të armiqve austro-hungarezë e bullgarë. Një gjyq i shpejtë, brenda javës e çoi atë para togës së pushkatimit në Selanik, më 9 nëntor 1917<sup>49</sup>.

Nga ana tjetër, pas hyrjes së Greqisë në luftë në krah të Antantës, ndryshoi edhe politika e francezëve karshi shkollave në Korçë dhe zonat

<sup>47</sup> Për një trajtim të thelluar të arsyeve që ndikuan në thellimin e mosmarrëveshjeve midis autoriteteve ushtarake dhe atyre diplomatike franceze shih: P. Milo, *Politika e Jashtme...*, f. 274-279.

<sup>48</sup> *Po aty*, f. 277, 279.

<sup>49</sup> *Po aty*, f. 280. Për një trajtim të thelluar në lidhje me ekzekutimin e Themistokli Gërmenjit nga autoritetet ushtarake franceze shih: M. Çami, *Shqiptarët dhe francezët në Korçë...*, f. 71-99.

përreth saj<sup>50</sup>. Më 13 dhjetor 1917, ministri i Punëve të Jashtme, Pichon i kërkoi ministrin të Luftës, Clemenceau:

*“që të porosisni autoritetet ushtarake të Korçës të autorizojnë rihapjen e shkollave greke dhe të sigurojnë mirëmbajtjen e shkollave shqiptare, duke u marrë vesh që si ato greke dhe ato shqiptare do t'i nënshtrohen kushteve të kontrollit që parashikon rregullorja ushtarake e zonës”*<sup>51</sup>.

Urdhri iu transmetua ushtarakëve francezë më 22 janar 1918 dhe komandanti i grupimit të Maliqit u urdhërua të merrte masat e nevojshme që “shkollat greke të ngrihen në këmbë të barabarta me ato shqiptare”<sup>52</sup>. Në këtë mënyrë, Franca vendosi ta zgjidhë situatën diplomatikisht, me anën e një kompromisi ndërmjet arsimimit në gjuhën greke dhe atij në gjuhën shqipe.

Pavarësisht urdhrit, rihapja e shkollave në gjuhën greke nuk ndodhi menjëherë, sepse akti binte ndesh me ligjin e votuar në mars të 1917-ës nga Këshilli Lokal i Korçës. Shfuqizimi i ligjit ndodhi vetëm pas abrogimit, më 16 shkurt 1918 nga komanda e lartë ushtarake franceze, të protokollit për krijimin e Krahinës Autonome të Korçës. Tashmë, krahina e Korçës dhe zonat përreth saj u vunë nën administratën e drejtpërdrejtë ushtarake franceze. Ky veprim i hapi rrugë rihapjes së shkollave në gjuhën greke, në të njëjtën kohë dhe të Gjimnazit Grek të Bangës. Në mbështetje të urdhrit të komandës së lartë franceze, shkollat fillore në

<sup>50</sup> Në notën që Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë i dërgoi, më 29 gusht 1917 homologes së saj franceze, e konsideroi të mjerueshme situatën në Korçë dhe masat e marra nga shqiptarët e të toleruara nga autoritetet franceze, në dëm të qeverisë greke. “*Bëhet e kuptueshme, thuhej në notë, se masat e marra kanë për qëllim të zvogëlojnë të drejtat e patjetërsueshme të helenizmit, i cili ia ka dalë gjithmonë mbanë të ruajë fenë dhe ndërgjegjen kombëtare përmes institucioneve arsimore, të respektuara deri dhe nga autoritetet osmane*”. Fajtor për gjendjen e krijuar konsiderohej koloneli Descoins, i cili akuzohej për perceptim të gabuar të situatës. Shih: *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και...*, f. 392-393. Ministria e Punëve të Jashtme greke për ambasadën në Paris, Athinë, 29 gusht 1917; *po aty*, f. 395-396. Ambasada e Parisit për Ministrinë e Punëve të Jashtme greke, Paris, 5 shtator 1917.

<sup>51</sup> Alexis Palaticy, *La zone d'occupation française en Albanie (1916-1920)*, Universita Marc Bloch Sciences Humaines, UFR des Sciences Historiques, Strasbourg, f. 51-52. Materiali është konsultuar në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë (AIH), A-IV-472, f. 52.

<sup>52</sup> *Po aty*, f. 53.

gjuhën shqipe nuk u mbyllën. Ato vazhduan të funksiononin së bashku me Liceun Francez, në përballje me shkollat në gjuhën greke dhe Gjinnazin e Bangës.

Ekzekutimi i Themistokli Gërmenjit, rihapja e shkollave greke dhe abrogimi i Krahinës Autonome të Korçës në vitin 1918 dhe më tej qëndrimi që Franca mbajti ndaj Shqipërisë në përfundim të Luftës së Parë Botërore<sup>53</sup>, i rikthyen sërish tonet dualiste ligjërimin intelektual me qendër Francën. Në shtypin lokal të kohës, vrasja e Th. Gërmenjit u konsiderua si “tragjedi”, jo vetëm për korçarët, por për të gjithë shqiptarët. Ajo ishte “shuplaka më e madhe” që i erdhi Shqipërisë nga Franca, e cilësuar tashmë jo si “liridhënësja dhe motra e madhe”, por si “mbrojtësja e dikurshme” e shqiptarëve.

Ja si shprehej *Gazet'e Korçës*, në shkrimin e saj editorial, më 10 nëntor 1920, tre vjet pas vrasjes së Themistokli Gërmenjit:

*“...Që me vrasjen e Themistokliut nis në një e nga një që të tregojnë mprojtësit e atëhershëm qëllimet e atëhershme qëllimet e tyre të fëlliqura. Vepra e parë ishte të çelurit e gjimnazos greke. Vepra e dytë dhe më me rëndësi, e cila zhdukte tërë punën e Themistokliut ishte të rrëzuarit e Protokollit të 10 Dhjetorit 1916, më 16 shkurt 1918, me anën e të cilit njiheshe si autonom Kaza e Korçës nën mbrojtjen ushtarake frënge dhe të kthyerit të Këshillës qeveritare të Korçës në Këshillë të Parisë”<sup>54</sup>.*

Por “shuplaka e madhe” ashtu sikurse edhe qëndrimi i diplomacisë franceze karshi shqiptarëve, u sfidua nga modeli qytetëruar dhe fryma

<sup>53</sup> Sipas studiueses Nikola Guy politika franceze në përfundim të Luftës së Parë Botërore ishte e ngjashme me atë të vitit 1913 dhe ashtu si atëkohë, ajo nuk i favorizonte shqiptarët. Për Quai d’Orsay-n në Shqipëri apo edhe më gjerë në Gadishullin Ballkanik, nuk luheshin interesa strategjike apo ekonomike. Të dy elementët përcaktues të politikës ballkanike franceze, sikurse interesat ruse dhe ndërhyrjet gjermane në Greqi, ishin eliminuar. Tashmë zyrtarët francezë i përdornin çështjet ballkanike për të fuqizuar rrjetin e aleancave të Francës kudo në Evropë për rritjen e sigurisë së saj. Shih: Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë. Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe lindja e pavarësisë shqiptare*, Tiranë: Pegi, 2012, f. 189.

<sup>54</sup> “Tragjedi e 9 Nëntorit 1917”, në *Gazet'e Korçës*, Vit i III, Num. 42, Korçë, 10 nëntor 1920, f. 1.

përparimtare e iluminizmit francez<sup>55</sup>, qasja pozitive ndaj të cilit vazhdoi të qëndronte fort si pjesë e pashmangshme në perceptimin për Francën të shqiptarëve në përgjithësi dhe të korçarëve në veçanti. Zhvillimet e mëtejshme në tryezat e diplomacisë ndërkombëtare treguan se dy qasjet e kundërta, që ravijëzuan perceptimin dual të shqiptarëve për Francën do ta sfidonin në vazhdimësi njëra-tjetrën, duke shprehur qartë ulje-ngritjet e herëpashershme në marrëdhënien shqiptaro-franceze.

### *S u m m a r y*

FROM "ENEMY" TO "FRIEND AND SPRINGHEAD OF CIVILIZATION":  
THE DUALISM IN THE ALBANIAN'S PERCEPTION ABOUT FRANCE  
(1913-1920)

The Albanian intellectuals discourse featured the perception about France through a dualistic relationship created under the impact of French diplomacy attitude towards the Albanians and the civilized model that the French state conveyed. This kind of ambiguity makes the negative settings about France as

<sup>55</sup> Koncepti i modernitetit në ligjërimin intelektual shqiptar të viteve 20 të shek. XX, u udhëhoq prej ideve të Iluminizmit Francez. Rast tipik i kësaj qasjeje mund të konsiderohet ligjërimi i publicistit Branko Merxhani, sipas të cilit ishte domosdoshmëri në edukimin e qytetarit shqiptar që elementët e qytetërimit perëndimor të depërtonin e të bëheshin pjesë e kulturës së tij. Për këtë duhej krijuar një shkollë dhe kulturë e lartë nacionale, e cila krahas injektimit të frymës kombëtare, do të përcillte edhe frymën perëndimore në shoqëri. Atje ku mungonte ideja pedagogjike, atje ku shkolla nuk ishte e zonja të përdorej si organi më i sigurt për përhapjen e frymës kombëtare dhe zbatimin e ideve të reja dhe të tendencave reformuese, atje shoqëria ishte e destinuar të mos përmbushte misionin e saj për të siguruar perspektivën e së nesërme. Në kuadrin e përgjithshëm të kumtit ligjërues të Merxhanit, shkolla franceze "Ecole des Roche", konsiderohej si vepra pedagogjike më monumentale e Francës, e cila duhej të ishte modeli edhe për arsimin shqiptar. Të njëjtin perceptim merrte edhe mësuesi francez, i cili ia kishte dalë "të injektonte" në shpirtrat e nxënësve të tij, idealizmin dhe shpirtin aktiv, cilësi këto të nevojshme edhe për nxënësin shqiptar. Shih: Branko Merxhani, "Edukata dhe reforma", në *Demokratia*, nr. 15, Gjirokastër: 1929.

the "enemy" of Albania's creation, "supporters of Albanian's disintegration," be challenged at the same time by positive ones such as the "country of freedom, equality and fraternity", "springhead" of civilization.

Ambiguity in the perception of Albanians for France fades in the years of World War I when the French created the Autonomous Republic of Korça. The policy designed by colonel Descoins in favor of "albanian national affirmation" gave a new perception for the France. From a Greek ally, the traditional enemy of Albanians, France was considered as a provider of freedom, as a "big sister", which *"after saving us from our traditional enemies gave us freedom and proclaimed our national self-governance which they took over under their highest protection [french soldiers]"*.

